



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1206/2 Prot.

Tiranë, më 30 . 11 . 2023

V E N D I M

Nr. 239 , Datë 30 . 11 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 238, datë 30.10.2023, e shtetasit E.M¹, i përfaqësuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), kundër Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. 4, Bashkia Durrës, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “identitetit gjinor” dhe “orientimit seksual”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Nga momenti i lindjes, kërkuesi është regjistruar në regjistrin e gjendjes civile me përbërësit e gjendjes civile “E.M”, gjinia “Mashkull”. Më pas, kuptoi se identiteti gjinor de facto nuk përshtatet me atë de jure. Kërkuesi nisi të marrë hapa drejt përshtatjes së pamjes së jashtme fizike me identitetin gjinor, më konkretisht, nga mashkull në femër. Kjo situatë ku momentalisht kërkuesi ndodhet, në statusin e një individi transgjinor, i ka sjellë një përballje të vazhdueshme me shoqërinë, duke ju shkaktuar poshtërim, diskriminim, gjuhë urrejtjeje dhe shpesh edhe dhunë nga komuniteti ku jeton. Situata, ku ndonëse pamja e jashtme fizike është ajo e një femre, por dokumentet personale të identifikimit pasqyrojnë ende identitetin e një mashkulli, i shkakton vështirësi në jetën e përditshme duke e ekspozuar ndaj sulmeve me përmbajtje dhune psikologjike dhe fizike.

Momentalisht kërkuesi ndjek studimet universitare pranë Fakultetit të Shkencave Sociale. Ndonëse duket si femër, emri i tij në regjistër ende është “E.M” dhe gjinia “mashkull”. Gjetja e një pune, hapja e një llogarie bankare, marrja me qira e një apartamenti ose udhëtimi

¹ Referuar Prokurës së Posaçme nr. Repertori: 1931, nr. koleksioni: 684, datë 09.09.2021.

përtej kufijve është shndërruar tashmë në një pengesë madhore për të, duke i pamundësuar gëzimin e jetës private në mënyrë normale.

Këto elementë të gjendjes civile, nuk pasqyrojnë më realitetin në të cilin kërkuesi jeton, e për më tepër, shkaktojnë ankth, urrejtje, vulnerabilitet e poshtërim ndaj tij, për shkak të identitetit gjinor. Situata faktike në të cilën ndodhet është një mospërputhje e plotë midis realitetit social dhe situatës faktike ligjore në një shkallë të tillë sa përbën një ndërhyrje flagrante në të drejtën përjetë private.

Për këtë shkak, nisur nga këto rrethana kërkuesi depozitoi fillimisht një kërkesë drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. 4, Bashkia Durrës, ku kërkoi ndryshimin e gjinisë, e më konkretisht nga “mashkull” në “femër” dhe ndryshimin e emrit nga “E” në “L”. Një ndryshim i tillë i përbërësve të gjendjes civile është një mjet që do të mundësojë gëzimin e të drejtave të parashikuara nga neni 8 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut si dhe do të parandalojë diskriminimin dhe stigmat me të cilat përballet çdo ditë për shkak të identitetit gjinor.

Kërkesa drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. 4, Bashkia Durrës, ka patur në objekt: “Kërkohet ndryshimi i përbërësve të gjendjes civile, konkretisht emrin nga “E.M” në “L.M”, si dhe ndryshimi i të dhënave zyrtare për gjininë nga “Mashkull” në “Femër”.

Zyra e Gjendjes Civile, në trajtimin e kërkesës së depozituar, është përgjigjur me shkresën nr. 925, datë 08.08.2023 nëpërmjet së cilës refuzon kërkesën, duke u shprehur jo në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi objektin e saj. Në trajtimin e rastit, për të mbështetur argumentimin e saj për refuzimin e kërkesës, Zyra e Gjendjes Civile e trajton atë nën dritën e përcaktimeve mbi “gabimet materiale”, duke arsyetuar sipas parashikimeve të nenit 36 të ligjit 10129/2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar.

Në objektin e kërkesës si dhe në brendësi të saj, identifikohet qartë shkaku se pse kërkuesi kërkon ndryshimin e përbërësve të gjendjes civile. Ky shkak lidhet me të qenurin e tij një shtetas transgjinor. Në asnjë moment në kërkesë nuk pretendohet dhe as kërkohet se në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile është bërë një “gabim material” lidhur me pasqyrimin e përbërësve të gjendjes civile, ashtu si shprehet Zyra e Gjendjes Civile.

Gjithashtu, subjekti ankues informon se: “Ligji nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar, ka si objekt kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë dhe përcaktimin e rregullave për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin e funksionimit të shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë. Në parim ky ligj e lejon ndryshimin e shënimit të gjinisë dhe të emrit në dokumentet zyrtare të gjendjes civile. Ligji parashikon se emrat mund të ndryshohen nëse

kanë kuptim të papërshtatshëm (neni 2), si dhe në rastin kur ka gabime materiale në regjistër (neni 57/7). Ndryshimi duhet të certifikohet me anë të një akti juridik lëshuar nga një ent ligjor që është përgjegjës për këto akte (neni 9). Ndryshimi i emrit mbështetet në faktin se emri është i papërshtatshëm, ndërsa ndryshimi i shënimit të gjinisë bazohet në faktin se gjinia/seksi i personit është ndryshuar, që provohet me vërtetim nga mjeku. Shënimi i gjinisë nuk mund të ndryshohet me vetëdeklarim. Personi duhet të jetë në zotërim të një vendimi gjykate për të kërkuar njohjen zyrtare të emrit të ndryshuar dhe të gjinisë së ricaktuar. Ndryshimet pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (neni 57/10).

Pavarësisht pretendimeve të institucioneve, vlen të përmendet se procedura ligjore e parashikuar nga ligji nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar, sa i përket ndryshimit të përbërësve të gjendjes civile, emrin por edhe gjininë, nuk janë të plota. Në kushtet dhe në situatën aktuale ligjore, të normuar nga këto përcaktime në terma reale është e pamundur që një shtetas transgjinator të ndryshojë gjininë dhe emrin. Vetëm në parim ky ligj e lejon ndryshimin e shënimit të gjinisë dhe të emrit në dokumentet zyrtare të gjendjes civile dhe kjo krijon shkaqe objektive për diskriminimin e tyre në shoqëri”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit në formën e “Diskriminimit të tërthortë”, “Diskriminimit ndërsektorial” dhe “Diskriminimit strukturor”, për shkak të “identitetit gjinor” dhe “orientimit seksual”, të kërkuarit, krijuar nga pamundësia e ndryshimit të përbërësve të gjendjes civile. Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri që në përputhje me parashikimet e nenit 32/1/ë të LMD-së, t’u rekomandojë autoriteteve kompetente, Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut duke u propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues me qëllim garantimin e të drejtave të shtetasve transgjinatorë për të ndryshuar përbërësit e gjendjes civile në përputhje me identitetin e tyre gjinor.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose

pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Ankuesi me shkresën/kërkesë datë 25.07.2023 drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. 4, Bashkia Durrës, ka kërkuar ndryshimin e përbërësve të gjendjes civile, konkretisht emrit nga “E.M” në “L.M”, si dhe ndryshimi i të dhënave zyrtare për gjininë nga “Mashkull” në “Femër” dhe pasqyrimin e ndryshimeve në regjistrin përkatës të Gjendjes Civile.

Zyra e Gjendjes Civile e Bashkisë Durrës, me shkresën nr. 925, datë 08.08.2023, ka kthyer përgjigje ankuesit dhe në mes të tjerash e ka informuar se: *“... Referuar nenit 38 të ligjit të Gjendjes Civile nr. 10129/2009, i ndryshuar, thuhet: “Lindjet si fakt, kohë, vend, gjini vërtetohen me asistencën e lindjes të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm në lindje”. Në rastin tuaj, verifikojmë se gjinia/seksi e përcaktuar në asistencën e lindjes lëshuar nga mamia pranë Spitalit Rajonal Durrës është mashkull. Gjithashtu referuar*

dhe aktit të lindjes të mbajtur në Zyrën e Gjendjes Civile nr. 4, Durrës, gjinia është mashkull. Në bazë të nenit 36 të ligjit të Gjendjes Civile nr. 10129/2009, i ndryshuar, i cili thotë: “në rast se në Regjistrin Kombëtar vërehen gabime materiale ose gjendet një rubrikë që nuk pasqyron përbërësit përkatës nëpunësi i gjendjes civile bën korrigjimin ose plotësimin e përbërësve në rastet kur përbërësi figuron në librat e akteve të lindjes. Në rastin në fjalë nuk kemi të bëjmë me gabim material pasi gjinia/seksi i përcaktuar në Asistencën e lindjes edhe në aktin e lindjes janë të sakta si në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe si të tilla nuk korrigjohen dhe as ndryshohen...”.

Pala ankuese në ankesën objekt shqyrtimi, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe ti rekomandojë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin e legjislacionit ekzistues, ligjit 10129/2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me pretendimin se ky ligj vjen në kundërshtim me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pasi cenon të drejtat e shtetasve transgjiorë për të ndryshuar përbërësit e gjendjes civile në përputhje me identitetin e tyre gjinor.

Ligji 10129/2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, parashikon se:

“Neni 6

Përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve

1. Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj.

Neni 8

Veçoritë e disa përbërësve të gjendjes civile

Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t’u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë.

Neni 36

Plotësimet dhe korrigjimet në Regjistrin Kombëtar

Kur në Regjistrin Kombëtar vërehen gabime materiale ose gjendet rubrikë, që nuk pasqyron përbërësin përkatës, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile bën korrigjimin ose plotësimin, kur:

- a) përbërësi figuron në librat e akteve, në regjistrat themeltarë të mëparshëm të asaj zyre ose të vendit prej nga ka ardhur, me ndryshim të vendbanimit, për çdo shkak;
- b) i interesuari paraqet dokumentin bazë nga burimi përgjegjës, sipas ligjit;

c) vërtetohet, në të gjitha rastet e tjera, me vendim gjykatë.

Për korrigjimin si gabim të provuar material të rubrikës së emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës, ndiqet procedura e parashikuar në nenin 57/7 e vijues të këtij ligji.

Neni 38

Dokumentet bazë të lindjes

1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.

2. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.

Neni 44

Ndryshimi i të dhënës së aktit të lindjes

Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në Regjistrin Kombëtar, mund të ndryshohet vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.

Neni 45

Plotësimi i të dhënave të aktit të lindjes

1. Në Regjistrin Kombëtar pasqyrohen të dhënat sikurse janë e për aq sa përmban akti i lindjes, shoqëruar me shënimin për të dhënat e përkohshme.

Neni 57

Rastet e ndryshimit të mbiemrit dhe të emrit

2. Emri mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:

- a) sipas rasteve të parashikuara në Kodin e Familjes, në rastin e birësimit;*
- b) me kërkesë të personit të interesuar, sipas procedurës së parashikuar në nenet 57/1 deri në 57/10 të këtij ligji, brenda 1 viti nga mbushja e moshës madhore, dhe vetëm një herë, si dhe sipas nenit 45 të këtij ligji.*

Neni 57/1

Procedura për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit me kërkesë të personit të interesuar

1. *Me përjashtim të rastit të korrigjimit të emrit/mbiemrit, çdo shtetas mund të kërkojë ndryshimin e emrit ose të mbiemrit pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin. Kërkesa duhet të përmbajë arsyen/shkakun e ndryshimit të emrit/mbiemrit dhe emrin/mbiemrin e ri që kërkohet të merret. Kërkesa paraqitet personalisht nga kërkuesi në zyrën e gjendjes civile përkatëse.*
2. *Kërkesa për ndryshimin e emrit të përkohshëm, të vendosur nga prindërit, mund të bëhet nga vetë personi brenda një viti nga data e mbushjes së moshës madhore. Në këtë rast kërkesa përmban datën dhe nënshkrimin e kërkuesit, i cili duhet të përcaktojë qartë emrin e përhershëm që kërkon të marrë.*
3. *Kërkesa për ndryshimin e emrit ose mbiemrit duhet të bëhet vetëm një herë dhe vetëm për shkaqe papërshtatshmërie. Kjo dispozitë nuk gjen zbatim në rastin e aplikimit të kërkesës për ndryshimin e emrit të përkohshëm, sipas pikës 2 të këtij neni. Në asnjë rast nuk mund të kërkohet marrja e mbiemrave që u përkasin personave me rëndësi historike, apo të tillë që mund të çojnë në lajthim, lidhur me përkatësinë e familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë/komunën ku ka vendbanimin kërkuesi, të përcaktuara si të tilla sipas procedurës së përmendur në pikën 4 të këtij neni.*
4. *Ministri përgjegjës për gjendjen civile parashikon me udhëzim rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave/mbiemrave që konsiderohen të papërshtatshëm, si dhe listën me emra dhe mbiemra të personave që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë/komunën ku ka vendbanimin kërkuesi, së bashku me një listë, pasi merr paraprakisht mendimin e institucioneve të specializuara. Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga zyrat e gjendjes civile, si dhe çdo organ tjetër shtetëror”.*

Në analizë të ligjit të sipërcituar, rezulton se në ligjin 10129/2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, nuk ka të përcaktuar një dispozitë në të cilën të parashikohet ndryshimi i gjinisë së shtetasve me kërkesë të tyre.

Në këtë kuptim dhe kërkesa e subjektit ankues për ndryshimin e përbërësit të gjendjes civile, në këtë rast të gjinisë, drejtuar zyrës së gjendjes civile të Bashkisë Durrës, nuk mund të shqyrtohej nga këto të fundit, pasi kërkesa për ndryshimin e gjinisë së shtetasve me kërkesë të tyre, është e panormuar nga legjislacioni shqiptar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është një institucion i ngarkuar nga ligji për të siguruar mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. (neni 21, i LMD) Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit (neni 22, i LMD), ndërsa kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashikohen nga neni 32, i LMD.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë², në nenin 131, pika 1 germat a) dhe c) ka sanksionuar se: *“1. Gjykata Kushtetuese vendos për: a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122 dhe c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare”*.

Në këtë mënyrë, baza dhe kufiri në ushtrimin e kompetencave për Komisionerin, janë Kushtetuta dhe ligjet në fuqi. Komisioneri ka kompetencë që të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar; të kryejë hetime kryesisht pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; por në çdo rast, ushtrimi i këtyre kompetencave bëhet në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Një ligj i cili vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, është një ligj i cili nuk është në përputhje me Kushtetutën, por gjykimin dhe vlerësimin për një gjë të tillë mund ta bëjë vetëm Gjykata Kushtetuese, si i vetmi autoritet i autorizuar nga Kushtetuta për të vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, marrja në shqyrtim e një pretendimi, nëse një ligj është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një kompetencë që Kushtetuta i'a ka njohur vetëm Gjykatës Kushtetuese dhe se asnjë institucion tjetër shtetëror, përfshi edhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili nuk mund të marrë në shqyrtim një çështje, për të cilën nuk ka kompetencë dhe kur shqyrtimi i kësaj çështje është në kompetencën e një tjetër institucioni.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b), ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji..”*, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet për t’iu nënshtruar shqyrtimit të mëtejshëm.

Në bazë të nenit 134, pika 1, germa “h” dhe pika 2, parashikohet: *“1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: h) organizatave; i) individëve. 2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”*.

Pala ankuese, ose Komiteti Shqiptar i Helsinkit, si një organizatë, e cila është e angazhuar në fushën e mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të shtetasve, në bazë të dispozitave të mësipërme kushtetuese mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për të vlerësuar dhe

² Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016

vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit në fjalë me Kushtetutën dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në kompetencat që i ka dhënë neni 32/1/ë³, i LMD-së, në vijim, do të vlerësojë mundësinë, nëse do i drejtohet me rekomandim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 238, datë 30.10.2023, të paraqitur nga shtetasi E.M, i përfaqësuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit kundër Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. 4, Bashkia Durrës, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

³ “Komisioneri ka kompetencë: ë) t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;”.